



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë - Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i
Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

Nr.Ref.01/13
01.03.2024

Ministrja e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në mbështetje të nenit 11, paragrafit 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.08/L-117 Për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 10 dhe 11, të Ligjit Nr. 06/L-113 Për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/01 mars 2019), nenin 15 të Ligjit Nr.08/L-018 Për Tregtinë me Produkte të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtërishme, nenit 4 paragrafi 1. nën paragrafi 1.1 dhe nën paragrafi 1.2, nenit 7 të Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr.03/2022 Për Rregullimin e Çmimeve të Produkteve të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtërishme dhe Masat e Tjera Mbrojtëse, shtojca 12 të Rregullores (QRK) Nr.04/2023 Për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë nxjerr:

VENDIM

1. Vendoset rregullimi i çmimeve dhe caktohen masat e tjera mbrojtëse për produktet e naftës të përdorshme në transport si vijon:

1.1. Marzha Tregtare maksimale e lejuar e shitjes me shumicë është dy (2) eurocentë për litër;

1.2. Marzha Tregtare maksimale e lejuar e shitjes me pakicë është dymbëdhjetë (12) eurocentë për litër;

1.3. Detyrohen subjektet për të furnizuar dhe për t'i ofruar për shitje produkte të naftës, si para vendosjes së çmimeve dhe masave mbrojtëse;

1.4. Mbikëqyrja e shtuar inspektuese;

1.5. Paraqitja e përshpejtuar e rastit te Autoriteti i Konkurrencës, kur ka dyshime për cenimin e konkurrencës së lirë.

2. Rregullimi i çmimeve dhe masat nga neni 1 i këtij Vendimi, mbeten në fuqi nëntëdhjetë (90) ditë, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.

3. Mbikëqyrjen e zbatimit të këtij vendimi bëhet nga Inspektorati i Tregut në bashkëpunim me Doganën dhe Administratën Tatimore.

ARSYETIM

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ka monitoruar rregullisht tregjet e produkteve të naftës dhe bazuar në evidencën ditore të pranuar nga Dogana e Kosovës lidhur me çmimet e furnizimit/ importit të produkteve të naftës si dhe raportet e përditshme nga Inspektorati i Tregut lidhur me çmimet e shitjes me shumicë dhe pakicë të produkteve të naftës, nga të cilat rezulton se lëvizjet e shpeshta të çmimeve në tregun ndërkombëtar reflektohen në tregun tonë të brendshëm kryesisht kur ka ngritje të çmimeve por jo edhe në rastet kur ka rënie. Prandaj, jo proporcionaliteti i çmimeve të naftës të deklaruar në import si dhe çmimeve në tregun tonë të brendshëm përbën shkas për rregullimin e çmimeve dhe caktimin e masave të tjera mbrojtëse sipas nenit 15, paragrafi 2, nënparagrafi 2.3 të Ligjit Nr.08/L-018 Për Tregtinë me Produkte të Naftës dhe Karburante të Ripërtrishme, nenit 3 paragrafi 2 nënparagrafi 2.3 të Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr.03/2022 Për Rregullimin e Çmimeve të Produkteve të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtërtrishme dhe Masat e Tjera Mbrojtëse.

Rregullimi i çmimeve dhe masave tjera mbrojtëse, caktohen në bazë të nenit 4 dhe nenit 6 të Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 03/2022 Për Rregullimin e Çmimeve të Produkteve të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtrishme dhe Masat e Tjera Mbrojtëse dhe ka për qëllim mbrojtjen e konsumatorit, për të mbrojtur konkurrencën dhe për të mënjeluar çrregullimet në treg.

Llogaritja e marzhës tregtare maksimale e lejuar për shitje me shumicë dhe pakicë bëhet sipas nenit 4 paragrafi 1.1 dhe 1.2. të U/A Nr. 03/2022 Për Rregullimin e Çmimeve të Produkteve të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtrishme dhe Masat e Tjera Mbrojtëse.

4. Duke u bazuar në atë që u cek më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

5. Ky Vendim hynë në fuqi një (1) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Rozeta HAJDARI

Ministre

Vendimi i dërgohet:

- *Kabinetit të Zyrës së Kryeministrit;*
- *Kabinetit të Ministres;*
- *Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;*
- *Doganës së Kosovës;*
- *Administratës Tatimore;*
- *Inspektoratit të Tregut;*
- *Departamenti për Rregullimin e Tregut të Naftës;*
- *Departamentit Ligjor;*
- *Arkivit.*